

KONTRATË SHITJE-BLERJE

KUOTASH

Sot, më datë 28.05.2024, ne seline e shoqërisë "Central Real Estate Partners" Shpk, me adrese: Tirane Rruga 'Muhamet Gjollësja', godina 73, hyrja 3, ap.27, nënshkruhet kjo kontratë shitje-bletje kuotash mes paleve dhe me përmbajtje si më poshtë vijon:

Z. Gerant Kollçaku, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tirane, me datë lindje 03.08.1991 pajisur me Letërnjoftimi ID nr.personal J10803089Q, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, i cili zotëron 100/100 kuotave që përbëjnë 100 % (100 përqind) të kapitalit të shoqërisë "Central Real Estate Partners" sh.p.k, person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datën 15.05.2024 me numër identifikimi (NIPT) M41615034D, (në vijim "Shitesi");

Dhe

1. **Z. Klajdi Kokla**, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tirane, me datë lindje 08.09.1996, pajisur me Letërnjoftimi ID nr.personal J60916017B, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, (në vijim "Bleresi);

Neni 1

Baza Ligjore e Kontratës

Baza ligjore e kësaj kontrate është Legjislacioni Shqiptar, përkatësisht ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" i ndryshuar dhe Kodi Civil Shqiptar, neni 659 e vijues, neni 761 e vijues, Statuti i shoqërisë, si dhe ligji Nr.9879, datë 21.02.2008 "Për titujt".

Neni 2

Kushte Paraprake

- Shoqëria "Central Real Estate Partners" shpk, është person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datën 15.04.2024, me numër identifikimi(NIPT) M41615034D, me seli në adresën Tirane Rruga 'Muhamet Gjollësja', godina 73, hyrja 3, ap.27, me vlerë kapitali 1.000,00 leke, numri i përgjithshëm i pjesëve 1;
- Shitesi **Gerant Kollçaku**, zotëron 100/100 kuotave që përbëjnë 100% të kapitalit të Shoqërisë "Central Real Estate Partners" shpk.
- Shitesi dëshiron të shesë bleresit, 50/100 të kuotave që zotëron në shoqërinë "Central Real Estate Partners" shpk, sipas kushteve të përcaktuara më poshtë.
- Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "Central Real Estate Partners" sh.p.k (e cila përbehet nga ortaku i vetëm **Gerant Kollçaku**), ka miratuar lejimin e shitjes të kuotave të kapitalit, objekt i kësaj kontrate.
- **Z. Klajdi Kokla**, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tirane me datë lindje 08.09.1996, pajisur me Letërnjoftimi ID nr.personal J60916017B, me zotësi madhore dhe me zotësi të plote juridike

per te vepruar, cilesuar si bleseri deshiron te bleje 50/100 te kuotave te Shoqerise "Central Real Estate Partners" sh.p.k.

Neni 3

Objekti i Kontratës

Objekt i kësaj Kontrate është shitja e 50% te kuotave të kapitalit të shoqërisë "Central Real Estate Partners" sh.p.k qe perfaqesojne 50% të të gjitha asetëve, pasurive dhe kontributeve financiare dhe monetare të përfshira dhe/ose investuara në shoqerine "Central Real Estate Partners" sh.p.k, si dhe vlerave të tjera që perfaqesohen prej tyre, siç figurojne të pasqyruara në bilancet dhe pasqyrat financiare të kesaj shoqerie dhe/ose dokumentacionin shkresor të kesaj të fundit, të cilat zotërohen nga Shitesi Shoqëria "Central Real Estate Partners" sh.p.k, me të dhenat e mesiperme.

Neni 4

Cmimi i Shitjes dhe menyra e pageses

Cmimi i shitjes se 50% te kuotave te zoteruara nga **Z.Gerant Kollçaku** ne kapitalin e shoqerise "Central Real Estate Partners" sh.p.k do te jete shuma prej 500.00 leke.

Neni 5

Kushtet e Kontratës

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitje, Shitesi, **Gerant Kollçaku**, humbet pronesine mbi 50% të kuotave që zoterohen prej tij ne shoqerine "Central Real Estate Partners" sh.p.k, duke humbur cilesine e tij per kete perqindje si pronar mbi asetet, kontributet dhe pasurite që perfshihen ne kapitalin e vet, kapitalin e regjistruar, te perfaqesuar nga kuotat që shiten.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitje, Bleseri, **Z.Klajdi Kokla**, fiton pronesine mbi 50% të kuotave te shoqerise "Central Real Estate Partners" sh.p.k, duke fituar cilesine si pronar per kete perqindje, mbi asetet, kontributet dhe pasurite që perfshihen ne kapitalin e vet, kapitalin e regjistruar, te perfaqesuar nga kuotat që shiten.

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shitje, shitesi, **Gerant Kollçaku**, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotat e shitura që përbëjnë 50% të kapitalit të zotëruar prej tij në shoqërinë "Central Real Estate Partners" sh.p.k, si dhe mbi asetet, pasurite dhe kontributet e tjera që perfaqesohen prej tyre.

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shitje, Bleseri, fiton çdo të drejtë pronësie mbi kuotat e blera që përbëjnë 50% të kapitalit të blere prej tij në shoqërinë "Central Real Estate Partners" sh.p.k., si dhe mbi asetet, pasurite dhe kontributet e tjera që perfaqesohen prej tyre (shih me lart).

Perfundimisht Shoqeria "Central Real Estate Partners" sh.p.k, ka dy ortak: **Z.Gerant Kollçaku** dhe **Z.Klajdi Kokla**, me nga 50% te vleres se kapitalit.

Neni 6

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve


Konfliktet dhe mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për ti zgjidhur në mirëkuptim me njëra-tjetrën. Nëse nuk arrihet një zgjidhje e tillë, do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) kopje, dy nga të cilat janë nga një për secilën palë, dhe një për tu depozituar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

PALËT


SHITESI

Gerant Kollçaku

A large, stylized handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Gerant Kollçaku'.

BLERESI

Klajdi Kokla

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Klajdi Kokla'.A large, stylized handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Klajdi Kokla'.